



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 8 shkurt 2018
Nr. ref.: RK 1195/18

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI103/17

Parashtrues

Arsim Hazeri

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të
Kosovës, Rev. nr. 44/ 2017, të 20 prillit 2017**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Arsim Hazeri nga Prizreni (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson avokati Naim Qelaj.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 44/2017, të 20 prillit 2017.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin sipas pretendimeve të parashtruesit tij janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 18 gusht 2017, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 25 gusht 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalović.
7. Më 11 shtator 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme të Kosovës.
8. Më 7 dhjetor 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 1 janar 2012, parashtruesi i kërkesës lidhi kontratën e punës nr. 12605 me Korporatën Energjetike të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KEK).
10. Kjo kontratë e punës është lidhur për kohë të caktuar prej një viti, duke filluar prej 1 janari 2012 deri më 31 dhjetor 2012.
11. Më 18 korrik 2012, organi disiplinor i shkallës së parë i KEK-ut, me vendimin nr. 1235/1, ia ndërpreu marrëdhënien e punës parashtruesit, me arsyetim se ai ka dështuar në realizimin e objektivave të përcaktuara të punës.

12. Më 20 korrik 2012, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesën nr. 4153 në organin disiplinor të shkallës së dytë të KEK-ut, duke theksuar se ndërprerja e marrëdhënies së punës është e kundërligjshme dhe se vendimi i punëdhënësit mbështetet në kushtet diskriminuese pasi që vlerësimi i objektivave të punës ishte bërë në bazë të “normës grupore” dhe se KEK-u nuk ka verifikuar fare realizimin e rezultateve personale në realizimin e objektivave të punës “norma individuale”.
13. Më 30 korrik 2012, organi disiplinor i shkallës së dytë i KEK-ut, me Vendimin 424, refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe vërtetoi vendimin e organit disiplinor të shkallës së parë të KEK-ut për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.
14. Më 7 gusht 2012, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Themelore në Prizren, me të cilën ka kërkuar anulimin e të dy vendimeve të KEK-ut dhe kthimin në vendin e punës.
15. Më 12 tetor 2012, Gjykata Themelore në Prizren me Aktgjykimin C. nr. 751/12 aprovoi padinë e parashtruesit dhe urdhëroi si në vijim:

“I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit Arsim Hazeri nga Prizreni, ashtu që anulohet vendimi i të paditurit EKK sh.a. – Divizioni i Rrjetit Prishtinë me nr. 1235/ 1 i datës 18.07.2012 dhe vendimi me nr. 424 i datës 30.07.2012 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

II. OBLIGOHET e paditura që paditësin ta kthej në vendin e punës të cilin e ka ushtruar si specialist i daljeve duke ia njohur të gjitha të drejtat nga vendi i punës dhe t’ia kompensoj të ardhurat personale nga vendi i punës sipas kontratës në lartësinë prej 400 € bruto në muaj duke filluar nga data 30.07.2012 deri në kthimin në punë me kamatë ligjore prej 3.5 % nga dita e parashtrimit të padisë nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

III. Me shpenzimet procedurale në shumën prej 452 € obligohet e paditura.”
16. KEK paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren.
17. Më 20 shtator 2016, Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktgjykimin AC. nr. 323/14 aprovoi ankesën e KEK-ut, ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, ashtu që kërkesëpadinë e parashtruesit e refuzoi si të pabazuar.
18. Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesën për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës. Në kërkesën për revizion, parashtruesi i kërkesës paraqiti se ndaj tij është bërë diskriminimi, se ndaj tij nuk është respektuar barazia para ligjit. Parashtruesi gjithashtu ka bashkangjitur edhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 85/14, të 20 majit 2014, sipas së cilit është aprovuar kërkesëpadia e paditësit E. M. i cili është koleg me parashtruesin e kësaj kërkesë dhe është larguar nga puna në kohën e njëjtë, për arsye të njëjta dhe në rrethana të ngjashme.
19. Më 20 prill 2017, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin Rev. nr. 44/2017, aprovoi pjesërisht revizionin e parashtruesit, ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës

së Apelit, në atë mënyrë që la në fuqi **pjesën I** të dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë që ka të bëjë me anulimin si të kundërligjshëm të aktvendimit të të paditurës KEK nr. 1235/1, dhe të vendimit me nr. 424, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Gjithashtu la në fuqi **pjesën III** të dispozitivit që ka të bëjë me shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 452 €.

20. Më tej, Gjykata Supreme e Kosovës ndryshoi **pjesën II** të aktgjykimit të shkallës së parë, ashtu që e detyroi të paditurën KEK që parashtruesit në emër të kompensimit të të ardhurave personale t'i paguajë shumën në lartësi prej 400 € për çdo muaj, duke filluar nga data 18 korrik 2012 e deri më 31 dhjetor 2012 (jo deri në kthimin në vendin e punës siç thuhej në vendimin e shkallës së parë, por deri në datën e përfundimit të kontratës së punës).
21. Në fund, Gjykata Supreme e Kosovës refuzoi revizionin në pjesën e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë që ka të bëjë me obligimin e të paditurës që në afat prej shtatë ditësh ta kthejë paditësin në punë dhe detyrat e mëparshme të punës, sipas kontratës së punës nr. 12605/O, të 1 janarit 2012 (duke arsyetuar se kontrata e punës për kohë të caktuar ka skaduar).

Pretendimet e parashtruesit

22. Parashtruesi i kërkesës së pari pretendon se ndërprerja e marrëdhënies së punës ishte e kundërligjshme dhe se atij do të duhej t'i takojnë të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, dhe si rezultat e kësaj edhe e drejta e kthimit në punë.
23. Parashtruesi i kërkesës konsideron se janë cenuar të drejtat themelore të garantuara me Kushtetutë, për shkak se e njëjta gjykatë për rastet identike për punëtorët e tjerë ka vepruar në favor të kërkesave për kthim në punë.
24. Parashtruesi konsideron se është “diskriminuar” dhe bashkëngjiti dy aktgjykime të Gjykatës Supreme të Kosovës (Rev. nr. 85/14, të datës 20.05.2014 dhe Rev. nr. 151/2013, të datës 05.06.2013) në të cilat punëtorët janë kthyer në punë.
25. Më tej, parashtruesi i referohet Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në rastin nr. KI89/13, duke theksuar se “*pretendimet e palës që parashtron kërkesën dhe faktet e tjera janë tërësisht identike me këtë rast*”.
26. Pastaj, parashtruesi konsideron se është shkelur neni 49 i Kushtetutës dhe arsyeton se “*ndërprerja e punës me vendim të kundërligjshëm i cili është anuluar, nënkupton sanimin e të gjitha pasojave të dëmshme që ka shkaktuar si akt juridik për personin pa fajin e tij*”.
27. Në fund, parashtruesi konsideron se Gjykata Supreme i ka interpretuar gabimisht dispozitat materiale të ligjit të punës “*në dëm të personit që është dëmtuar pa të drejtë me vendimin e kundërligjshëm*”.
28. Për shkak të asaj që u tha më sipër, parashtruesi konkludon se atij nuk i është “*ofruar mbrojtje adekuate gjyqësore dhe ligjore*”, dhe kështu ka ardhur deri te

“shkelja e nenit 31 të Kushtetutës [...] lidhur me nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së”.

29. Parashtruesi konsideron se *“nuk i është mundësuar gjykim të drejtë edhe për faktin se pavarësisht provave që kanë qenë në favor të tij, të gjitha këto janë interpretuar në dëm të parashtruesit të kërkesës”, dhe kështu është shkelur edhe neni 55 i Kushtetutës “me faktin se janë cenuar dhe janë kufizuar të drejtat dhe liritë themelore siç është e drejta për punë”.*
30. Në bazë të asaj që u tha më lart, parashtruesi kërkon që Gjykata të konstatojë se *“ka pasur shkelje të nenit 24 [...], nenit 49 [...], nenit 53 [...], nenit 55 [...], nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës [...], lidhur me nenin 6. 1 (e drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së”.*
31. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata:

Të shpallë të pavlefshëm aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 44/2017 të datës 20.04.2017 për pjesën me të cilën është refuzuar revizioni i parashtruesit.

Të kthejë në rivendosje aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 44/2017 të datës 20.04.2017 për pjesën me të cilën është refuzuar kërkesa e palës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

32. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me tej me Ligj dhe të parashikuara me Rregullore të punës.
33. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*„1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]*

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

34. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Lidhur me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

„Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor”.

35. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kushteve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën si individ dhe në cilësinë e palës së autorizuar, duke kontestuar një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Rev nr. 44/2017] të 20 prillit 2017, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kushtet e nenit 48 të Ligjit, dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet nga neni 49 i Ligjit.
36. Megjithatë, Gjykata më tej duhet të vlerësojë nëse janë përmbushur kriteret e parapara në rregullin 36 të Rregullores së punës.
37. Rregulli 36 [Kriteret e pranueshmërisë], paragrafët (1) (d) dhe (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, përcakton:
- „(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:
[...]
d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
- (2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
[...]
b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;
d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*
38. Gjykata së pari vëren se parashtruesi të gjitha pretendimet e tij i ka lidhur me trajtimin e pabarabartë në raport me personat e tjerë të cilëve KEK-u ua ka ndërprerë marrëdhënien e punës.
39. Më tej, kërkesa themelore e parashtruesit është lidhur me kthimin e tij në vendin e punës dhe ai konsideron se aktgjykimin i kontestuar e ka shkelur të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të drejtën e tij të punës, sepse e refuzoi kërkesën e tij për kthim në vendin e punës.
40. Nga ajo që u tha më sipër, Gjykata konkludon se në thelb kërkesa e parashtruesit ngre pretendime për shkelje të neneve 24, 49 dhe 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
41. Për këtë arsye, Gjykata do të analizojë në detaje shkeljet e pretenduara të neneve 24, 49 dhe 31 të Kushtetutës.

(i) Shkeljet e pretenduara të nenit 24 të Kushtetutës në lidhje me nenet e tjera

A. Parimet e përgjithshme në lidhje me diskriminimin

42. Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së e cila thotë se „*diskriminimi do të thotë trajtim ndryshe, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, të personave në situata relativisht të ngjashme*” (shih: *Willis kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 48 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së, të 11 shtatorit 2002; *Bekos dhe Koutropoulos kundër Greqisë*, paragrafi 63, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 13 marsit 2006).
43. Në mënyrë që pretendimet e parashtruesit në lidhje me diskriminimin të jenë të suksesshme, ai *inter alia* duhet të dëshmojë se pozita e tij mund të konsiderohet e ngjashme me pozitën e një personi tjetër i cili ka pasur trajtim më të mirë (shih: *Fredin kundër Suedisë* (nr. 1), paragrafi 60, GJEDNJ, Aktgjykimi i 18 shkurtit 1991).

B. Aplikimi i parimeve të lartpërmendura në këtë rast konkret

44. Gjykata vëren se në mbështetje të pretendimeve të tij lidhur me “*diskriminimin dhe trajtimin e pabarabartë*” parashtruesi i kërkesës bashkëngjiti dy aktgjykime të Gjykatës Supreme të Kosovës (Rev. nr. 85/ 14, të datës 20.05.2014 dhe Rev. nr. 151/ 2013, të datës 05.06.2013) në të cilat punëtorët janë kthyer në punë.
45. Më tej, parashtruesi pretendon se Gjykata Supreme “*për rastet identike, për punëtorët e tjerë ka vepruar në favor të kërkesave për kthim në punë*”.
46. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi nuk ka paraqitur argument bindës për të mbështetur pretendimin e tij se ishte trajtuar ndryshe nga Gjykata Supreme, në krahasim me punëtorët tjerë.
47. Gjykata i analizoi në detaje aktgjykimet e përmendura të Gjykatës Supreme dhe konstatoi se “*nuk i ka trajtuar ndryshe, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, personat në situatat relativisht të ngjashme*”.
48. Prandaj, Gjykata vëren se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës (Rev. nr. 85/14, i datës 20.05.2014) ka të bëjë me një punëtor të KEK-ut i cili ka qenë në marrëdhënie të përhershme të punës me KEK-un, ndërsa parashtruesi i kërkesës në këtë rast ka qenë në marrëdhënie të punës për kohë të caktuar.
49. Prandaj, Gjykata konkludon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës (Rev. nr. 85/ 14, i datës 20.05.2014) nuk ka të bëjë me “*rastet identike*”, siç pretendon parashtruesi i kërkesës.
50. Gjykata analizoi edhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 151/2013, të 5 qershorit 2013. Me këtë Aktgjykim është aprovuar si e bazuar kërkesa e punëtorëve të KEK-ut që të anulohen vendimet e KEK-ut për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe kërkesa për kthim në vendin e punës dhe lënda është kthyer në rigjykim nga Gjykata Supreme.

51. Megjithatë, bazat ligjore të cilat janë aplikuar në këtë lëndë dhe bazat ligjore të cilat kanë qenë në aplikim tek parashtruesi i kërkesës nuk janë të njëjta.
52. Gjkata vëren se në momentin e zhvillimit të kontestit dhe nxjerrjes së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 151/2013, të 5 qershorit 2013, ka qenë në aplikim Ligji i Punës nr. 12/1989 të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24.
53. Për dallim nga kjo, aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është nxjerrë në bazë të Ligjit të Punës së Republikës së Kosovës nr. 03/L-212, i cili ndërkohë hyri në fuqi dhe ishte i aplikueshëm në momentin kur parashtruesi e inicioi kontestin.
54. Nga sa u tha më sipër, Gjkata konkludon se dy aktgjykimet e Gjykatës Supreme të cilave u referohet parashtruesi nuk janë marrë në të njëjtën kohë dhe as në situatat relativisht të ngjashme, siç pretendon ai.
55. Gjithashtu, Gjkata ka analizuar edhe Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në rastin nr. KI89/13, në të cilin thirret parashtruesi. Gjkata konkludoi se rrethanat dhe situata juridike në Aktgjykimin nr. KI89/13 ishin identike, ndërsa trajtimi i Gjykatës Supreme ishte i ndryshëm, ndërsa në lëndën konkrete nuk kemi një situatë të tillë juridike.
56. Në dritën e këtyre fakteve dhe sqarimeve, Gjkata konkludon se kemi rrethana të ndryshme dhe situata të ndryshme juridike në krahasimin e parashtruesit dhe punëtorëve të tjerë të KEK-u për të cilët ka vendosur Gjkata Supreme.
57. Prandaj, Gjkata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për diskriminimin dhe trajtimin e pabarabartë të bërë nga Gjkata Supreme janë të pabazuara, sepse Gjkata Supreme *“nuk i ka trajtuar ndryshe, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, personat në situatat relativisht të ngjashme”*.

(ii) Shkeljet e pretenduara të nenit 49 të Kushtetutës në lidhje me nenet e tjera

58. Parashtruesi më tej thirret në shkeljen e nenit 49 të Kushtetutës, të cilën e arsyeton se ndërprerja e punës ka ndodhur me *“vendim të kundërligjshëm i cili është anuluar, nënkupton sanimin e të gjitha pasojave të dëmshme që ka shkaktuar si akt juridik për personin pa fajin e tij”*.
59. Lidhur me këto pretendime të parashtruesit, Gjkata i referohet nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. E drejta e punës garantohet.

2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës”.

60. Gjkata thekson se e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit është objekt i mbrojtjes kushtetuese, me ç'rast këto të drejta, më tej, realizohen në mënyrë dhe sipas kushteve të përcaktuara me ligj, dhe kjo nënkupton edhe të drejtën e një individi që marrëdhënia e tij e punës të mos ndërpritet në kundërshtim me atë që është përcaktuar me ligj.

61. Nga shkresat e lëndës vërtetoi se janë të sakta pretendimet e parashtruesit se marrëdhënia e punës i është ndërprerë në mënyrë të kundërligjshme me vendimet e KEK-ut. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme shfuqizoi si të paligjshme të dy vendimet e KEK-ut.
62. Megjithatë, Gjykata konsideron se aktgjykimi i Gjykatës Supreme, që është kontestuar nga parashtruesi ka eliminuar të gjitha pasojat negative për parashtruesin në atë mënyrë që Gjykata Supreme *“e detyroi të paditurën KEK që parashtruesit në emër të kompensimit të ardhurave personale t’i paguaj shumën në lartësi prej 400 € për çdo muaj, duke filluar nga data 18.7.2012 e deri më 31.12.2012”*.
63. Për më tepër, Gjykata gjen se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme i cili kontestohet nga parashtruesi i kërkesës ia ka njohur parashtruesit të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës për kohë të caktuar nga momenti kur kjo marrëdhënie e punës është ndërprerë në mënyrë të kundërligjshme deri në momentin kur ka përfunduar.
64. Më tej, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit që të kthehet në vendin e punës, pavarësisht faktit se kontrata e tij e punës për kohë të caktuar ka skaduar më 31 dhjetor 2012, nuk paraqet të drejtën e mbrojtur me nenin 49 të Kushtetutës.
65. Gjykata vëren se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk e cenon të drejtën e parashtruesit sipas nenit 49, pasi që ky Aktgjykim në asnjë mënyrë nuk e parandalon parashtruesin që të punojë dhe të ushtrojë profesionin. Me këtë Aktgjykim, Gjykata Supreme thjesht konfirmoi se marrëdhënia e punës e parashtruesit e lidhur për kohë të caktuar kishte përfunduar sipas fuqisë ligjore pas skadimit të kohës për të cilën ishte lidhur kontrata (shih: Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në rastin nr. KI78/15, të 21 dhjetorit 2015, paragrafi 31).
66. Prandaj, Gjykata konkludon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme në asnjë mënyrë nuk e shkelë të drejtën kushtetuese të parashtruesit që të punojë dhe të ushtrojë profesionin.

(iii) Shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe me nenet e tjera

67. Gjykata rikujton se parashtruesi konsideron se Gjykata Supreme ka interpretuar gabimisht të drejtën materiale dhe se parashtruesit *“nuk i është mundësuar gjykim i drejtë edhe për faktin se pavarësisht provave që kanë qenë në favor të tij, të gjitha këto janë interpretuar në dëm të parashtruesit të kërkesës”*.
68. Nga sa u tha më sipër, parashtruesi konkludon se atij nuk i është *“ofruar mbrojtje adekuate gjyqësore dhe ligjore”* dhe kështu ka ardhur deri te shkelja nga „neni 31 i Kushtetutës [...] lidhur me nenin 6. 1 (e drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së“.
69. Gjykata përsërit që nuk është funksion i Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e pretenduara në aplikimin e ligjeve përkatëse që pretendohet të jenë

bërë nga gjykatat e rregullta, nëse me këtë aplikim nuk janë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ (shih: *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, paragrafi 28 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së, të 21 janarit 1999).

70. Gjykata konsideron se Gjykata Supreme dha përgjigje të arsyetuar ndaj të gjitha pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me arsyet e aplikimit të rregullave përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale.
71. Gjykata vëren se çështja kryesore e cila është ngritur para gjykatave të rregullta ka qenë çështja e *“kthimit e parashtruesit në vendin e punës”*, ku Gjykata Supreme në aktgjykimin e kontestuar arsyetoi përse kjo kërkesë e parashtruesit është e pabazuar:

„Paditësi ka qenë i punësuar te e paditura nga data 1.1.2012 deri më 31.12.2012 sipas kontratës së punës nr. 12605/0 nga data 1.1.2012. Nga fakti se paditësi ka krijuar marrëdhënie pune me kohë të caktuar, në bazë të nenit 67 par 1 pika 3 të Ligjit të Punës nr. 03/L- 212, kontrata e punës mund të ndërprehet sipas fuqisë ligjore me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës, andaj Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykata e shkallës së dytë në mënyrë të drejtë ka zbatuar të drejtën materiale në pjesën e aktgjykimit të saj kur ka vlerësuar se kërkesëpadia e paditësit që të obligohet e paditura ta kthejë në punë dhe detyrat e mëparshme të punës, është e pabazuar.“

72. Më tej, Gjykata Supreme në aktgjykimin e kontestuar i arsyetoi edhe të drejtat të cilat i takojnë parashtruesit nga kontrata për kohë të caktuar në këtë mënyrë:

“Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se, sipas dispozitës së nenit 80 par. 1 pika 1 të Ligjit të Punës, e paditura ka obligim që paditësit t’ia paguaj pagat sipas kontratës së punës, mirëpo kjo Gjykatë vlerëson se konstatimi i gjykatës së shkallës së parë se qëndron obligimi i të paditurës që paditësit t’ia paguaj pagat mujore në shumë prej 400 € deri në kthimin e tij në punë është i paqëndrueshëm, ngase paditësit i takojnë vetëm pagat e papaguara sipas kontratës së punës nr. 12605/0 datë 1.1.2012“.

73. Sidoqoftë, Gjykata thekson se, është detyrë e gjykatave të rregullta t’i zgjidhin çështjet e interpretimit të ligjit. Kjo veçanërisht vlen për aplikimin e ligjeve përkatëse dhe interpretimin e të drejtës materiale dhe procedurale nga ana e gjykatave të rregullta (shih: *Pekinel kundër Turqisë*, paragrafi 53, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 18 marsit 2008). Roli i Gjykatës është vetëm të përcaktojë nëse efektet e interpretimit të tillë janë në pajtim me Kushtetutën, veçanërisht ato të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
74. Prandaj, Gjykata vëren se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është arsyetuar në detaje dhe shpjegon qartë pse është refuzuar kërkesa e parashtruesit për kthimin e tij në vendin e punës.
75. Gjykata, më tej, vëren se parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e procedurës në gjykatat e rregullta. Megjithatë, ky fakt nuk mund vetvetiu të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih: *mutatis mutandis* rastin *Mezotur* -

Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, paragrafi 21, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

76. Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur t'i paraqesë dhe t'i mbështesë pretendimet se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

(iv) Shkeljet e pretenduara të neneve 53 dhe 55 të Kushtetutës në lidhje me nenet e tjera

77. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon edhe shkelje të neneve 53 dhe 55 të Kushtetutës, mirëpo nuk arsyeton se në çfarë mënyre janë shkelur këto nene të Kushtetutës, por konsideron se shkeljet e këtyre dy neneve kanë rezultuar nga lidhshmëria e tyre me nenet 24, 31 dhe 49 të Kushtetutës.
78. Meqenëse Gjykata i ka analizuar në detaje shkeljet e pretenduara të neneve 24, 31 dhe 49 të Kushtetutës dhe ka vërtetuar se me aktgjykimin e kontestuar nuk janë shkelur këto nene të Kushtetutës, Gjykata nuk do të lëshohet në një analizë të detajuar të pretendimeve për shkelje të neneve 53 dhe 55 të Kushtetutës.
79. Si përfundim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet se aktgjykimi i kontestuar në çfarëdo mënyre ka qenë i padrejtë apo arbitrar dhe se me aktgjykimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (shih: *mutatis mutandis*: *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).
80. Prandaj, Gjykata konsideron se kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara me tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës, nuk janë përmbushur.
81. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit është e papranueshme, si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113 (1) dhe (7) të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (2) (b) dhe (d) dhe 56 të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 7 dhjetor 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Bekim Sejdiu

Gjyqtari raportues



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi